



FTESE PËR TAKIM

15 Shkurt 2021

Drejtuar:

- Z. Ilirjan Celibashi, Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
- Z. Ilir Meta, President i Shqipërisë
- Z. Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë
- Z. Lulzim Basha Kryetar i Partisë Demokratike
- Znj. Monika Kryemadhi, Kryetare e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim
- Z. Pandeli Majko, Ministër i Shtetit për Diasporën
- Znj. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit
- Z. Bledar Milaqi, bashkëthemelues i Lëvizjes “Diaspora për Shqipërinë e Lirë”
- Z. Lirim Krasniqi, Drejtor Ekzekutiv i Germinit
- Z. Marin Nati, përfaqësues i Shoqatës së Avokateve Shqiptaro-Kanadez
- Përfaqësisë së OSBE-së në Shqipëri, Ambasador Vincenzo Del Monaco

Të nderuar

Çështja e të drejtës së votës së Diasporës ka qenë rregullisht prioriteti i të gjithë grupeve të interesit në Diasporë. Me krijimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Këshilli Koordinues i Diasporës (KKD) së bashku me grupet e tjera të interesit në Diasporë, ka marrë pjesë aktive në procesin e realizimit të votës së Diasporës për zgjedhjet e 25 prillit 2021.

Megjithë ndihmën që kemi dhënë qoftë në konsultimet me grupin e punës të KQZ-së ashtu dhe me propozime dhe zgjidhje konkrete për finalizimin e kuadrit ligjor, konstatojmë zvarritje dhe mungesë vullneti për realizimin e votës së Diasporës.

Në situatën ku ndodhemi sot, sipas KQZ-së kuadri ligjor është i bllokuar me arsyetimin se mungon konsensusi politik.

Nuk pajtohemi me vonesat e shkaktuara dhe përmes kësaj letre ju ftojmë në një takim virtual me qëllim për të zhbllokuar ngërçin e konstatuar në proces.



KËSHILLI KOORDINUES I DIASPORËS

Duke marrë parasysh kohën e shkurtër në dispozicion për realizimin e kuadrit të nevojshëm ligjor, ky takim duhet të kryhet sa më shpejtë, mundësisht në një nga datat 15-19 Shkurt.

Në pritje të konfirmimit tuaj.

Mark Gjonaj
Kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës
(917) 731-6850
Markgjonaj1@gmail.com